



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2489/ 9 prot.

Datë 14.10.2024

V E N D I M
Nr. 1441/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.10.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK si dhe shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “*Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Anbim*” në procedurën e

prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “*Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*I & V Company*” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “*Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit dhe lënien të skualifikuar operatorët ekonomikë “*Florfarma*” SHPK, “*Anbim*” SHPK dhe “*I & V Company*” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “*Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK, me Nipt K21405001N, me adresë: Rruga “Qazim Vathi”, Nr. 72, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Anbim*” SHPK, me Nipt L81618008J, me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “*I & V Company*” SHPK, me Nipt M01809026H, me adresë: Rruga “Qelqit”, Kombinat, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK, me Nipt K91624505A, me adresë: Fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3 , Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.07.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 05.08.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 27.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anbim” SHPK	12.902.000	lekë skualifikuar
2. “Murati D” SHPK	13.171.000	lekë skualifikuar
3. “Florfarma” SHPK	15.040.000	lekë skualifikuar
4. “I & V Company” SHPK	15.151.515	lekë skualifikuar
5. “Euro Mega 2010” SHPK	15.272.000	lekë kualifikuar
6. “Pastrime Silvio” SHPK	16.000.000	lekë kualifikuar
7. “Besim Kamberi” PF	16.243.000	lekë kualifikuar
8. “Atlantik 3” SHPK	16.420.000	lekë skualifikuar
9. “Get Klin” SHPK	16.165.000	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 27.08.2024, operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme), pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit)nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit.

II.4.1. Në datën 03.09.2024 është Publikuar Njoftim Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4.2. Në datën 04.09.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2024/4523 dhe me nr. 2489/2024 prot, datë 06.09.2024, e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij si më poshtë vijon:

Konkretisht ka paraqitur fatura tatimore shitje për produkte të ngjashme, brenda afateve të kërkuara, me bashkinë vlorë, ent publik, që arrijnë në vlerën 2,345,328.50 lekë. Gjithashtu, operatori ekonomik Florfarma shpk ka paraqitur fatura tatimore shitje për produkte të ngjashme, me subjekt privat dhe shëndetësore shtetërore, brenda afateve të kërkuara, të cilat arrijnë vlerën 11,298,471.74 lekë (produkte të ngjashme detergjent dhe dezinfektantë). Edhe nëse nga këto fatura (dëshmi) zbresim vlerën e produkteve të cilët nuk janë detergjent apo dezinfektantë vlera e faturave vetëm për produkte të ngjashme (detergjent, dezinfektant) arrin në masën 12,921,800.24 lekë. Kjo vlerë e tejkalon masën 39 % të fondit limit, si kërkesë teknike e kërkuar në këtë procedurë, pra nga ana jonë janë respektuar kërkesat e pikës 1 të seksionit 2.3 specifikime teknike, kriteret të veçanta të kualifikimit. Nga të gjitha llogaritjet nga ekspertët Florfarma shpk nuk rezulton që të jemi para mospërbushjes së vlerës 39% të fondit limit, pasi e dokumentuar me dëshmi sipas kriterëve ligjore, produktet e ngjashme e tejkalojnë vlerën 39 % të fondit limit. Janë gabime në llogaritje nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertës, mbi vlerën e shitjes së produkteve të ngjashme, që janë paraqitur nga OE Florfarma shpk dhe për këtë arsye është e nevojshme marrja e një eksperti nga ana juaj për shqyrtimin e ankesës në themel, ashtu sic parashikon edhe ligji. Ju kërkojmë gjithashtu të bëni unifikimin e procedurave për kriteret e veçanta të kualifikimit për të shmangur, abuzimin me togfjalëshin furnizime të ngjashme, sepse përsa i përket produkteve objekt të këtij tenderi, shoqëria Florfarma shpk është edhe prodhues i tyre, duke qënë e vetdijshme në këtë mënyrë, për cdo produkt të ngjashëm, përfshirë këtu edhe përbërjen kimike. Është lehtësisht e evidentueshme që shtojca 6, loti 1 blerje DETERGJENT, DEZINFEKTANT DHE aromatizuesë ka emërtimin e 13 artikujve të cilët në përbërje të tyre janë të ngjashëm me artikuj në faturat e paraqitura nga Florfarma, si dëshmi për furnizime të ngjashme dhe në këtë mënyrë e bën të paligjshme refuzimin e ofertës nga ana juaj për OE Florfarma shpk. Në përforcim të asaj që deklaroam mësipër, përmendim kërkesat specifike të artikullit 5: Solucion larës ËC dezinfektues ku vetë emri përcakton kërkesën për dezinfektantë. Së dyti, nëse marrim në konsideratë përbërësit kimik të produkteve të kërkuara, përmendet përbërësi kimik klorë klasifikuar si dezinfektant. Për të vazhduar më tej në kërkesat specifike të shumicës së produkteve, kërkohet një përbërje me bazë acide, e specifikuar PH 0,1-3, përbërje e cila gjen përdorim në rastin e asgjësimit të mikroorganizmave dhe si rrjedhojë ky produkt konsiderohet

dezinfektant (jo vetëm detergjent) artikulli 7 dhe 10. Ne mendojmë që skualifikimi është abuziv dhe në kundërshtim me ligjin ose vjen për shkak të një përlllogaritje të gabuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi nga ana jonë janë plotësuar të gjitha kriteret teknike dhe specifikimet e vecanta, të kërkuara për produktet e ngjashme, qoftë për vlerën e fondit limit, qoftë për përbërjen e tyre. Së dyti kërkojmë, shfuqizimin vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin fitues të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik EURO MEGA 2010 në procedurën e prokurimit, shpallur më datë 03.09.2024, pasi oferta e paraqitur prej saj në vlerën 15.272.000 lek është më e madhe se oferta e paraqitur nga Florfarma shpk. Pra në këto kushte, unë do tëi sha shpallur fituesi pasi kisha një ofertë më të favorshme për (subjektin tenderues).

II.4.3 Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2489/3 prot., datë 09.09.2024 janë publikuar kriteret e kualifikimit dhe pretendimet për operatorin ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për të cilat ngre ankimuesi “Florfarma” SHPK, në ankesën me nr. 2489/2024 prot., datë 06.09.2024.

II.4.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 2489/4 prot, datë 16.09.2024 nga operatori ekonomik i interesuar “Euro Mega 2010” SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.4.5. Me shkresën nr. 756/23 prot, datë 17.09.2024 protokolluar me tonën me nr. 2489/5 prot datë 18.09.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë “Florfarma” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK , lidhur me informacionin dhe dokumentacion, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK, ku me vendimin nr. 756/22 prot, datë 17.09.2024, ku ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 27.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Anbim” SHPK	12.902.000	lekë skualifikuar
2.	“Murati D” SHPK	13.171.000	lekë skualifikuar
3.	“Florfarma” SHPK	15.040.000	lekë skualifikuar
4.	“I & V Company” SHPK	15.151.515	lekë skualifikuar
5.	“Euro Mega 2010” SHPK	15.272.000	lekë kualifikuar
6.	“Pastrime Silvio” SHPK	16.000.000	lekë kualifikuar

7.	“Besim Kamberi” PF	16.243.000	lekë kualifikuar
8.	“Atlantik 3” SHPK	16.420.000	lekë skualifikuar
9.	“Get Klin” SHPK	16.165.000	lekë kualifikuar

II.5.1. Në datën 27.08.2024 operatori ekonomik “Anbim” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

- *Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është hedhur sipas formatit të shtojcës 8 të DST , pasi rezulton se formulari i paraqitur nga ofertuesi në SPE nuk është i plotë pasi është hequr pjesa e fundit e formularit standart si më poshtë: “Ju lutemi sigurohuni që:*

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*

- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*

- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

Heqja e një pjese të formularit bie në kundërshtim me Pikën 4 (Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve) të gërmës B (PËRGATITJA E OFERTAVE) të Seksioni I te DST , ku thuhet qartë se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”

- *Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm për artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit) nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit. Konkretisht nga verifikimi i Faturave të paraqitura ne SPE rezulton se:*

- *Fatura nr. 402/2023 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 405/2023 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.*

- Fatura nr.374/2023 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 40/2024 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.
- Fatura nr 13/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturat nr.30/2022 dhe faturën nr.15/2022 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.
- Fatura me nr 120/2022 rezulton e korigjuar (me vlerë negative) me faturat nr.123/2022 dhe 127/2022 dhe nuk llogariten vlerat e korigjuara.
- Fatura nr.65/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 70/2022 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.

II.5.2. Në datën 03.09.2024 është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt - ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.5.3. Në datën 08.09.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2024/4531 dhe me nr. 2503/2024 prot, datë 09.09.2024, e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij si më poshtë vijon:

OE Anbim shpk pretendon qe arsyet e skualifikimit te publikuara ne SPE nuk jane te bazuara ne ligj dhe konkretisht ne LPP nr 162/2020 dhe VKM Nr 285 Neni 26 i VKM Nr 28.

Nga plotesimi i pergjigjeve OE ANBIM shpk ka deklaruar qe nuk eshte bashkim operatoresh dhe ka deklaruar qe eshte i vetem ne kete procedure dhe ka deklaruar vetem NIPT-in e tij. Duke falenderuar ligjvensin per kujtesen qe ben ne DT ne pjesen ku mbaron formulri i vetdeklarimit nuk ka te pasqyruar asnje vetdeklarim dhe nuk ka te ngarkuar asnje vetdeklarim te ndonje operatori tjetere. Duke falenderuar ligjvensin per kujtesen qe ben ne DT ne pjesen ku mbaron formulri i vetdeklarimit ju eshte pergjigjur saktesisht qe nuk ka nenkontraktor dhe nuk mbeshtetet ne kapacitetet e asnje subjekti. Nuk ka asnje nekontraktor dhe asnje subjekt mbi kapacitetet e te cilit do te mbeshtetet OE Anbim shpk. Duke mos pasur te tille ne DT te ngarkura ne SPE nuk ka dhe vetdeklarime te subjekteve te tjera. Ne pjesen e formulait Deklarata per Permbushjen e Kriereve te Pergjithhme OE Anbim shpk ka deklaruar duke deklaruar saktesisht pozicionin e tij ligjor ekonomik dhe Teknik. Ne deklaratat e ngrkuara ne SPE ne menyre specifike jepen dhe burimet e informacionit qe jane te aksesueshme nga ana e AK. Pjesa II: Shkaqet e perjashtimit A: DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT. Deklarata Operatori ekonomik eshte i regjistruar ne regjistrin tregtar sipas legjislacionit te vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit te Posacem ne rastin e nje organizate jofitimprurëse, ka ne fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: <https://qkb.gov.al/> <https://e-albania.al/> dhe dokumenti është Ekstrakti i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuarë dhe Ekstrakti Historik Tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuarë. Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-<https://e-albania.al/> dhe dokumenti është dëshmi penaliteti

nga Ministria e drejtësisë Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Emër mbiemër Vendlindja datëlindja ID Detyra M. J, XX/XX/XXXX IXXXXXXXXXA Administrator nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: <https://e-albania.al/> dhe dokumenti është certifikatë e Gjendjes gjyqësore (dëshmia e Penalitetit) dhe organi lëshues është Ministria e drejtësisë, Drejtoria e përgjithshme e Burgjeve.

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë është dëshmi Penaliteti nga Ministria e drejtësisë. Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: <https://ëëë.tatime.gov.al/> dhe dokumenti është vërtetime për statusin Aktiv, Pasive etj dhe organi lëshues është drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM. Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e republikës së shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: ëëë.e-albania.al dhe dokumenti është vërtetim debie dhe organi lëshues është oshee Group sh.a.(FSHU). Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së Operatori ekonomik i ka paguar taksat lokale Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: ëëë.e-albania.al dhe dokumenti është vërtetim për pagim detyrimesh dhe organi lëshues është ministria e Financave dhe ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. OE do të dorzojë vërtetimin e pagimit të taksave lokale për vitin 2023 nëq shpallet fitues. Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: <http://app.gov.al> dhe dokumenti është operatorët ekonomik të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik dhe organi lëshues është agjencia e Prokurimit Publik. Duke falenderuar ligjvënës për kujtesën që ben në DT ne pjesen ku mbaron formulari i vetdeklarimit, OE Anbim shpk ka deklaruar të gjitha burimet e aksesueshme me qellim që AK të verifikojë cdo informacion të deklaruar në këtë pjesë. Gjithashtu në vetdeklarim OE Anbim shpk ka deklaruar që është në dijeni për pasojat që vijnë nga një vetdeklarim i pasakte. Arsyeja e KVO që është hequr pjesa e fundit e formularit të vetdeklarimit të dorzuar në SPE duke e bërë aresye për skualifikim

mendojme qe nuk eshte i sakte dhe i drejte Formulari i vetdeklarimit mbaron ne pjesen ku ligjvenesit ka caktuar: Emri Mbiemri Firma Vula Data e dorzimit te delarates. Pjesa e hequr qe pretendon KVO e AK Operatori Blerjeve te Perqendruara nga formulari i vetdeklarimit nuk eshte pjese perberese e formularit. Ne kulturen tone cdo dokument zyrtar perfundon me vendosjen e firmes dates dhe vules Pjesa tjeter per te cilen KVO vendos qe eshte pjese perberese e formularit te vetdeklarimit duke cenuar formen dhe permbajtjen e dokumentit nuk eshte i drejte dhe pasojte duhet te anulohet. Pjesa per te cilen KVO e quan pjese perberese te formularit eshte kujtese qe ligjvenesit me te drejte e ka vendosur ne DT per Operatoret Ekonomike dhe vendodhja e saj mbas perfundimit te formularit te vetdeklarimit nuk e ben ate ne asnje menyre pjese perberese te formularit. Me poshte jepet pjesa fundore e formularit te vetdeklarimit te ngarkuar ne SPE Ne kete duket qarte qe formulari nuk e permban pjesen qe KVO pretendon qe eshte hequr. Theksojme qe ne kete forme formularin e vetdeklarimit OE Anbim e ka dorezuar ne te gjitha procedura prokurimi qe ka marre pjese dhe ka zhvilluar AK Operatori Blerjeve te Perqendruara NE ASNJE RAST TE VETEM FORMULARI I VETDEKLARIMIT NUK ESHTE QUAJTUR I PARREGULLTE DHE SHKAK PER SKUALIFIKIM NGA KY AUTORITET. GJITHASHTU KJO FORME E FORMULARIT TE VETDEKLARIMIT ESHTE PERDORUR NE TE GJITHA PROCEDURAT E PROKURIMIT KU OE ANBIM SHPK KA MARRE PJESE DHE ASNJE AK NUK E KA QUAJTUR TE PARREGULLTE. Me vendimin Nr 519/2023 te KPP formulari i vetdeklarimit te shoqerise ANBIM shpk eshte marre ne analize dhe nuk eshte quajtur i pasakte apo jo i plote Formulari i vetdeklarimit ne formen qe eshte hedhur ne SPE per kete procedure eshte hedhur dhe ne shume procedura prokurimi te zhvilluara nga AK Operatori Blerjeve te perqendruara dhe ne asnje rast nuk ka perbere shkak per skualifikim.

II Aresye tjeter per skualifikim per OE Anbim shpk eshte si me poshte: Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret vecanta te kualifikimit (Deshmi per furnizime te ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm per artikuajt e ngjashëm me objektin e prokurimit) nuk plotëson limitin prej 39 % te fondit limit Ne DT qe AK ka ngarkuar ne SPE thuhet: 2.3 Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. B-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të.

Vlera e faturave te ngarkuara ne siatem eshte 11. 922. 363 Leke Vlera e faturave te ngjashme qe kerkohet eshte $19.092.667 * 0.39 = 7.446.140.13$ leke.

1- Fatura nr. 402/2023 e ka vlerem + 102.001 rezulton e korigjuar totalisht me fat 405/2023 qe e ka vleren -102001 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë. Keto fatura i takojne institucionit Drejtoria

Policise Vlore. Per kete institucion ekziston dhe fatura 406/2023 me vlere 102.001. Nga ana jone ne librin e shitjeve eshte eliminuar 405/2023 me 406/2023. Ky furnizim eshte kryer.

2- Fatura nr. 374/2023 e ka vleren + 60.666 ndersa fat 40/2024 e ka vleren 77.821. Keto dy fatura nuk kane asnje lidhje me njera tjetren pra nuk e korigjojne njera tjetren. Kjo fature qendron dhe nuk duhet te hiqet por duhet te llogritet si furnizim i ngjashem. Vendimi i KVO per te mos e llogaritur nuk eshte i drejte.

3- Fatura nr 13/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me 30/2022 dhe 15/2022 dhe nuk llogaritet si faturë. Kjo duhet hequr jemi dakord.

4- Fatura me nr 120/2022 ka vleren 1.013.645 nuk mund te korigjohet me faturat 123 qe e ka vleren – 3.437 dhe faturen 127 qe e ka vleren – 2100.00 lek Fatura 120/2022 nuk duhet te hiqet.

5- Fatura nr 65/2022 me vlere rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr 70 /2022 dhe nuk llogaritet si fature. Keto fatura i takojne institucioni ndërmarrja e mirëmbjtjes së Infrastruktures dhe punëve Publike Pogradec.

Per kete intucion jane prere keto fatura 65/2022 me vlere 57.8460, 70/2022 me vlere -57.8460, 79/2022 me vlere +578.460, 80/2022 me vlere -578.460, 81/2022 me vlere + 578.460. Ky furnizim per kete institucion eshte kryer prandaj kjo fature do te hiqet.

Kjo fature qendron dhe nuk duhet te hiqet por duhet te llogritet si furnizim i ngjashem.Vendimi i KVO per te mos e llogaritur nuk eshte i drejte.

Mendojme se duhet te sjellin ne vemendje qe sistemi ifiskalizimit ishte ne fillimet e veta dhe prandaj kemi dhe fatura te anulluara OE eshte nje nga prodhuesit kryseore te detetgjenteve ne vend Linjat e prodhimit qe disponojme jane:

1-Linja prodhimit e spunit te tualetit dha ate te rrobave

2-Linja e prodhimit te pluhurit lares

3-Linja e prodhimit te ambalazheve plastic per detergjente

4-Linja e prodhimit te detergjenteve te lengshem

5-Linja e prodhimit te produkteve aerosol 6-linja e prodhimit produkte kozmetike.

Asnje prodhues vendas nuk i ka te gjitha linjat e prodhimit te pershkruara me siper. Nga ana jone ne SPE eshte ngarkuar 1-Deklarata qe jemi prodhues; 2-Katallogu produkteve; 3-vertetim mbi xhiron;

4-Bilancet financiare 2021,2022,2023

Arsyeja e dyte qe OE Anbim skualifikohet eshte ai me pohte

Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret vecanta te kualifikimit (Deshmi per furnizime te ngjashme) pasi vlere totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit) nuk ploteson limitin prej 39 % te fondit limit Me cte drejte KVO ne dokumentat e tenderit kerkon fatura te ngjashme dhe na skualifikon se nuk plotesojme kushtin

per fatura te ngjashme me artikuj te ngjashem me objektin e prokurimit qe e thekson tek shkaqet e kualifikimit.

Vleresimi jo sipas kriterëve të DT por sipas një dëshire nuk është i drejtë dhe nuk duhet pranuar Vlera e faturave të ngjashme edhe pas korigjimit të gabimeve duke u bazuar në pikën 1 të seksionit 2.3 të kapacitetit Teknik të DT është 9.415.000 lek pra ne mendojme qe e permnbushim kete pike Neqoftese AK do te ishte shprehur sakte dhe qarte per oe anbim shpk nuk aspak problem per te deshmuar nje vlere prej 7.446.140.1 lek me artikuj te njellojte me proceduren e prokurimit mbasi vlere xhiros per tre vitet e fundit

Viti 2023 34210248 lek

Viti 2022 17300595 lek

Viti 2021 2280173 le

Totali 74.312.573 lek

Ne jemi prodhues detergjentesh te cilen e kemi treguar ne shume procedura prokurimi. Ne procedure e prokurimit me REF -96420-02-26-2024 te Zhvilluar nga AK Operatori i blerjeve te Pergendruara per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve me vlere te fondit limit 39.951.333 lek vlera e faturave te ngarkuara ne sistem eshte 19.235.327 lek dhe artikujt te se njejtes natyre jane shume here mbi 7446140.1 lek. Kjo verteton qe ne kemi pervoja Mendojme qe kete konfuzion e ka krijuar AK i cili nuk i ka shprehur kjarthe dhe sakte kerkesat e tij. OE Anbim eshte mosbesues dhe pretendon qe AK ka shkelur parimin themelor te ligjit te prokurimeve publike ate te barazise.

II.5.4 Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2503/2 prot., datë 10.09.2024 janë publikuar kriteret e kualifikimit për operatorin ekonomik “Anbim” SHPK për të cilat ngre ankimesi “Anbim” SHPK, në ankesën me nr. 2503/2024 prot., datë 09.09.2024.

II.5.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 2503/3 prot, datë 16.09.2024 nga operatori ekonomik i interesuar “Euro Mega 2010” SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.5.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve shtese nr. 2503/4 prot, datë 19.09.2024 dhe 2503/6 prot, datë 30.09.2024 nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK.

II.5.7. Me shkresën nr. 756/27 prot, datë 19.09.2024 protokolluar me tonën me nr. 2503/5 prot datë 20.09.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK, lidhur me informacionin dhe dokumentacion, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik

ankimues “Anbim” SHPK, ku me vendimin nr. 756/26 prot, datë 19.09.2024, ku ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 27.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Anbim” SHPK	12.902.000	lekë skualifikuar
2.	“Murati D” SHPK	13.171.000	lekë skualifikuar
3.	“Florfarma” SHPK	15.040.000	lekë skualifikuar
4.	“I & V Company” SHPK	15.151.515	lekë skualifikuar
5.	“Euro Mega 2010” SHPK	15.272.000	lekë kualifikuar
6.	“Pastrime Silvio” SHPK	16.000.000	lekë kualifikuar
7.	“Besim Kamberi” PF	16.243.000	lekë kualifikuar
8.	“Atlantik 3” SHPK	16.420.000	lekë skualifikuar
9.	“Get Klin” SHPK	16.165.000	lekë kualifikuar

II.6.1. Në datën 27.08.2024 operatori ekonomik “I & V Company” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

- Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme), pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm për artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit) nuk plotëson limitin prej 39% të Fondit limit.

II.6.2. Në datën 03.09.2024 është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt - ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.6.3. Në datën 09.09.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2024/4532 dhe me nr. 2508/2024 prot, datë 09.09.2024, e operatorit ekonomik “I & V Company” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij si më poshtë vijon:

I & V Company shpk qe ne momentin e themelimit ka realizuar 100% vetem procedura me Produkte pastrimi. Pra 100% e xhirove tona vjetore jane me produkte pastrimi. Ne pa asnje lloj problemi mund te kishim hedhur fatura vetem me detergjent, por duke ju referuar ligjit dhe kerkeses tuaj ne kriteret per kualifikim ku kerkohet: 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

A. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

B. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

I&V Company per te plotesuar kete pike ka paraqitur kontrate plus vertetim realizimi me Drejtoria e Pergjithshme e Kopshteve dhe Cerdheve Tirane ne vleren 13.747.000 leke pa TVSH, duke e tejkualuar vleren 39% te fondit limit, dhe nuk kemi dorezuar ne SPE asnje fature sic shpreheni ne arsyen e skualifikimit. Per te plotesuar kriterin furnizime te ngjashme operoret ekonomik duhet te paraqesin kontrata apo fatura te ngjashme me objektin e prokurimit qe prokurohet dhe jo kontrata te njejta pasi ne kete rast do te quheshin kontrata te njejta apo furnizime te njejta si rrjedhoj i kerkeses tuaj kjo pike eshte e plotesuar nga ana jone dhe skualifikimi juaj eshte i padrejte. Ne grupin e kodeve produkte pastrimi bejne pjese emertimet e kodeve detergjente, fshesa, sfungjer, kova, peceta, pastrues dysHEMEJE, produkte pastrimi etj. Sa me siper te gjithe emertimet e artikujve te paraqitur ne kontrate nga ana jone bene pjese ne grupin e kodeve Produkte pastrimi. Pra kontrata jone me artikujt qe perfshin eshte e ngjashme sic kerkohet ne kriteret e kualifikimit. Duke ju referuar dosjes se tenderit Autoriteti Kontraktor ka percaktuar Kodi CPV 24452000-7 me emertimin e kodit Insekticide si dhe CPV 33711900-6 me emertimin sapun. Me vendim Nr. 457 date 30.7.2021 per miratimin e fjalorit te perbashket te prokurimit Shtojca 1 paragrafi 2 thuhet shprehimisht: Ne cdo rast per zhvillimin e nje procedure prokurimi Autoriteti ose Entet Kontraktore duhet te zgjedhin detyrimisht ne sistemin e prokurimit elektronik nje prej kodeve te percaktuara qe i korrespondon objektit konkret te prokurimit. Pra ju e keni KONKRETIZUAR objektin e prokurimit me INSEKTICIDE qe bejne pjese ne Grupin e kodeve Produkte kimike dhe me Sapun qe bejne pjese ne grupin e kodeve Pajisje mjekësore, farmaceutike dhe produkte të kujdesit personal. Atehere dhe kontrata jone eshte me artikuj te ngjashem me objektin e prokurimit pasi cdo procedure ne SPE prokurohet me ato artikujt pasi bejne pjese ne nje grup dhe jane nje fushe produkte pastrimi. Kjo pike eshte e permbushur nga ana jone me vertetim realizimi, ku tregon qarte se subjekti ka realizuar kontrate te ngjashme sic eshte kerkuar tek kriteret per kualifikim, jo per artikujt te ngjashem sic eshte arsyeja e skualifikimit. Duke shpresuar dhe besuar ne punen tuaj per kualifikimin e subjektit tone, Ju urojme Pune te mbare.

II.6.4 Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2508/2 prot., datë 10.09.2024 janë publikuar kriteret e kualifikimit për operatorin ekonomik “I & V Company” SHPK për të cilat ngre ankimesi “I & V Company” SHPK, në ankesën me nr. 2508/2024 prot., datë 09.09.2024.

II.6.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 2508/3 prot, datë 16.09.2024 nga operatori ekonomik i interesuar “Euro Mega 2010” SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.6.6. Me shkresën nr. 756/25 prot, datë 18.09.2024 protokolluar me tonën me nr. 2508/4 prot datë 19.09.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë “I & V Company” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK, lidhur me informacionin dhe dokumentacion, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “I & V Company” SHPK, ku me vendimin nr. 756/24 prot, datë 18.09.2024, ku ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve shtese nr. 2508/5 prot, datë 23.09.2024 nga operatori ekonomik “I & V Company” SHPK.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 27.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Anbim” SHPK	12.902.000	lekë skualifikuar
2.	“Murati D” SHPK	13.171.000	lekë skualifikuar
3.	“Florfarma” SHPK	15.040.000	lekë skualifikuar
4.	“I & V Company” SHPK	15.151.515	lekë skualifikuar
5.	“Euro Mega 2010” SHPK	15.272.000	lekë kualifikuar
6.	“Pastrime Silvio” SHPK	16.000.000	lekë kualifikuar
7.	“Besim Kamberi” PF	16.243.000	lekë kualifikuar
8.	“Atlantik 3” SHPK	16.420.000	lekë skualifikuar
9.	“Get Klin” SHPK	16.165.000	lekë kualifikuar

II.7.1. Në datën 27.08.2024 operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.7.2. Në datën 03.09.2024 është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt - ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.7.3. Në datën 12.09.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2024/4547 dhe me nr. 2574/2024 prot, datë 12.09.2024, e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, nëpërmjet së cilës kërkon lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të

skualifikimit për operatorët ekonomik “Florfarma” SHPK, “Anbim” SHPK dhe “I&V Company” SHPK me argumentat si më poshtë vijon:

Ne lidhje me kërkesën tonë për ti shtuar arsyet për skualifikim Anbim SHPK, Florfarma SHPK; I&V Company SHPK e argumentojmë si më poshtë vijon:

Se pari: 1- Ofertuesin Anbim SHPK, nuk ka paraqitur shtojcën 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit), sipas shtojcës 8 të DT-së, të firmosur dhe vulosur sic duhet si dhe nuk ka plotësuar saktë dhe me të gjithë dhënat e kërkuara në këtë formular standart të DT-së, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos pasqyruar në të gjitha të dhënat që ky formular parashikon, referuar kërkesave për kualifikim të përcaktura në shtojcën 7 të DT-së. Një prej arsyeve për skualifikim të dhënë nga KVO-ja për këtë ofertues është se, Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit nuk është hedhur sipas formatit të shtojcës 8 të DST, pasi rezulton se formulari i paraqitur nga ofertuesi në SPE nuk është i plotë pasi është hequr pjesa e fundit e formularit standart pra rezulton se, ky ofertues nuk ka dorëzuar të plotë dhe të saktë Formularin e vetdeklarimit. Gjithahstu ne pretendojmë se përvec pasaktësisë së mësipërme në lidhje me këtë formular vetdeklarimi ofertuesi Anbim SHPK ka edhe mangësi të tjera të cilat nuk janë konstatuar nga KVO-ja. Ne pretendojmë se, ky ofertues nuk ka nënshkruar dhe vulosur sic duhet formularin shtojcën 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit), të DT-së, pra formulari nuk është firmosur nga administratori i shoqërisë apo personi i autorizuar prej tij si dhe nuk është i vulosur me vulën e shoqërisë. Këtë pretendim tonin e bazojmë edhe në faktin se, ky ofertues edhe në një tjetër procedurë prokurimi është skualifikuar për këtë shkak dhe ne besojmë që edhe në këtë procedurë prokurimi ky formular nuk është nënshkruar dhe vulosur rregullisht sipas formularit standart. Operatorit ekonomik Anbim SHPK, ka paraqitur ofertën e tij për procedurën e prokurimit iprocedurë e Hapur e Thjeshtuarë me Nr. REF-97401-03-05-2024, me objekt blerje materiale pastrimi, me fond limit 1,366,230 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejës, procedurë në të cilin është skualifikuar për arsyen e mëposhtme për skualifikim: arsyet e skualifikimit: Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, i kërkuar në pikën 1 të DST-së, është paraqitur pa nënshkruar dhe vulosur në asnjë nga faqet e saj. Ne përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese KPP-ja me Vendimin e saj Nr. 541 /2024, datë 22.05.2024.

Se dyti: - Gjithashtu Ofertuesit Anbim SHPK, Florfarma SHPK dhe I&V Company SHPK nuk kanë plotësuar saktë me të gjitha informacionet e kërkuara formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT-së. Dhe nenin 76 kriteret detyruese për skualifikim të ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik.

Ne shtojcën 7 të DT-së kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: Shtojca 7 [shtojcë për tûu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor] Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit Ofertuesi deklaroi se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- a) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Kriteret e përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, për sa më sipër.

2. Kriteret e Vecanta Te Kualifikimit 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8... Në kriteret për kualifikim të përcaktura në kapacitetin teknik të shtojcës 7 të DT-së nga AK-ja janë kërkuar: ..3. Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet për transportin e mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje. Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtem:

Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet për transportin e mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qira/huapërdorje

Per mjetin e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë ne pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, certifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.

Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 3.1: Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik, për të realizuar shperndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të këtë punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore i thjeshtë	1
Total	2

Për punonjës in shofer të paraqitet:

- Leje drejtimi përkatëse e mjetit.
- Kontrate pune

Për punonjës in punëtor i thjeshtë të paraqitet:

- Kontrate pune

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE mund të paraqesë edhe 1 punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatës të mjetit, dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave, objekt prokurimi, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës. Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 4.1: Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Referuar dispozitave ligjore si më sipër ne besojmë se, ofertuesit Anbim SHPK, Florfarma SHPK, I&V Company SHPK nuk i kanë plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT-së, e në mënyrë të vecantë ne besojmë se, këta ofertues nuk i kanë plotësuar të dhënat në lidhje me: 1- Adresat përkatëse dhe dokumnetat konkrete për të dhënat të cilat AK-ja mund të verifikojë dhe aksesojë direkt, informacioni e pasqyruar nga dy ofertuesit në formularin e vetdeklarimit dhe të cilat gjenden në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion e konkretisht për deklaratimet si më poshtë: [...]

- Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posacme. Rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: -----etj.

Nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e republikës së shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

- Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

- Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose bikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.

Ofertuesit Anbim SHPK, Florfarma SHPK, I&V Company SHPK nuk kanë plotësuar në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas (shtojca 8), Pjesa III, Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, B: deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), me informacionin e kërkuar në këtë formular, duke mos dhënë informacion të plotë në përmbushje të kriterit 2.3.3 e konkretisht nuk ka listuar apo evidentuar numrin e makinerive, llojin e mjetit, targën si dhe statusin e këtyre mjeteve (Pronesi/qira/huapërdorje) si të dhëna minimale për të vërtetuar deklaratën e tij, në përmbushje të kërkesës në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas (shtojca 8), Pjesa III, Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, B: deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, inëse po, të listohen me të dhëna konkreteë, mbi disponim të mjeteve të nevojshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar.

Gjithashtu ofertuesit Anbimë SHPK, Florfarma SHPK, I&V Company SHPK nuk kanë plotësuar në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas (shtojca 8), Pjesa III, Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, B: deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), me informacionin e kërkuar në këtë formular, duke mos dhënë informacion të plotë në përmbushje të kriterit 2.3.4 e konkretisht nuk ka listuar apo evidentuar stafin e kërkuar, profilet e tyre, deklaramet se cilët punonjës do të angazhojë, emër, mbiemer, pozicioni i punës, për këtë procedurë prokurimi në përmbushje të kësaj kërkesë për kualifikim në të cilën në mënyrë të qartë nga AK-ja është përcaktuar: Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates, pra referuar kësaj kërkese por edhe të kriterit në tërësi ofertuesi duhet të deklarojë punonjësit konkret të cilët do të angazhohen në këtë kontratës, me emër dhe mbier se cili do të jetë shofer apo cili do të jetë punëtor, të dhëna minimale për të vërtetuar deklaratën e tij, në përmbushje të kërkesës në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas (shtojca 8), Pjesa III, Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, B: deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, inëse po, nëse, po, numri i punonjësve dhe Profili i punonjësve. Ne rastin konkret, ofertuesit nuk i kanë pasqyruar të dhënat e plota në rubrikat përkatëse në Formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT-së, lidhje me informacionin e kërkuar në kriteret për kualifikim 2.3.3 dhe 2.3.4 të kapaciteit teknik të shtojcës 7 të DT-së.

Për pasojë, ne vlerësojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës Anbim SHPK, Florfarma SHPK; I&V Company SHPK në këtë procedurë prokurimi nuk i kanë plotësuar kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, në lidhje me informacionet të cilat detyrimisht duhet të vendosen dhe deklarohen në shtojcën 8 të DT-së në, pra nuk kanë paraqitur shtojcën 8 sipas kërkesësave të përcaktura nga AK-ja në shtojcën 7 kriteret e veáanta të kualifikimit, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos dhënë të dhëna që ky formular parashikon.

Te njejtat qendrime ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik në vendimet e tij; Ne vendimet interpretuese Nr. 835/2023, date 29.08.2023;, Nr. 833 /2023, date 29.08.2023;, Nr. 672/2024, datë 12.06.2024;, Nr. 135/2023, datë 23.02.2023;, dhe Nr. 1237/2023, datë 30.11.2023.

Gjithashtu kërkojmë të qëndrojnë të gjitha arsyet e tjera për skualifikim të dhëna respektivisht për ofertuesit për të cilët kemi kërkuar tu shtohen arsyet e skualifikimit me anë të kësaj ankese.

Për gjithë sa më sipër, kërkojm shtimin e arsyeve për skualifikim për ofertat e dorëzuara nga ofertuesit Anbim SHPK; Florfarma SHPK; I&V Company SHPK, sipas arsyetimit të dhënë në këtë ankesë, si oferta të cilat nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktura nga autoriteti kontraktor.

1- Për ofertuesin Anbimë SHPK, të shtohet arsyeja për skualifikim: nuk ka paraqitur shtojcën 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit), sipas shtojcës 8 të DT-së, të firmosur dhe vulosur sic duhet si dhe nuk ka plotësuar saktë dhe me të gjithë dhënat e kërkuara në këtë formular standart të DT-së, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos pasqyruar në të gjitha të dhënat që ky formular parashikon, referuar kërkesave për kualifikim të përcaktura në shtojcën 7 të DT-së.

2- Për Ofertuesit Florfarma SHPK dhe I&V Company SHPK, për secilin të shtohet arsyeja për skualifikim: Ofertuesi, nuk kane paraqitur shtojcën 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit), sipas shtojcës 8 të DT-së, të plotësuar saktë dhe me të gjithë dhënat e kërkuara në këtë formular standart të DT-së, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos pasqyruar në të gjitha të dhënat që ky formular parashikon, referuar kërkesave për kualifikim të përcaktura në shtojcën 7 të DT-së.

Duke shpresuar në një vlerësim të drejtë, objektiv, profesional nga na juaj dhe në përputhje me qëllimet dhe parimet e ligjit të prokurimit public, kërkojmë pranimin e plotë të ankesës tonë.

II.7.4 Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2574/2 prot., datë 13.09.2024 janë publikuar kriteret e kualifikimit për cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Florfarma” SHPK, “Anbim” SHPK dhe “I&V Company” SHPK për të cilat ngre ankimuesi “Euro Mega 2010” SHPK, në ankesën me nr. 2574/2024 prot., datë 12.09.2024.

II.7.5. Me shkresën nr. 756/30 prot, datë 23.09.2024 protokolluar me tonën me nr. 2574/3 prot datë 25.09.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë “Florfarma” SHPK, “Anbim” SHPK dhe “I&V Company” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK, lidhur me informacionin dhe dokumentacionin, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK, ku me vendimin nr. 756/28 prot, datë 20.09.2024, ku ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Anbim” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është hedhur sipas formatit të shtojcës 8 të DST, pasi rezulton se formulari i paraqitur nga ofertuesi në SPE nuk është i plotë pasi është hequr pjesa e fundit e formularit standart si më poshtë: “Ju lutemi sigurohuni që: - Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit. Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik. Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Heqja e një pjese të formularit bie në kundërshtim me Pikën 4 (Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve) të germës B (përgatitja e ofertave) të Seksioni I të DST, ku thuhet qartë se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” nuk qëndron Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private

të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:

<p>e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p>_____</p> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës të Vetdeklarimit.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

“Blerje Detergjent, hipoklorit natriumi, insekticide dhe rodenticid për Qendrën Spitalore Universitar “Nënë Tereza” e ndarë në 3 (tre) lote. Loti I. “Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” per Operatori i Blerjeve të Përqendruara Adresa Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 3, Tiranë per proceduren me nr REF-12059-07-03-2024 Loti 1: REF 12064-07-03-2024

I. Unë e nënshkruari në cilësinë e ADMINISTRATORIT të operatorit ekonomik “ANBIM” SH.P.K. deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	“ANBIM” SH.P.K. 100%
Numri NIPT/et:	“ANBIM” SH.P.K., NIPT: L81618008J
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	RrugaAutostradaTirane Durres km 1Tiranë
Përfaqësuesi (emri):	
Telefoni:	
E-mail:	eshjakupi@yahoo.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
<ul style="list-style-type: none"> • Informacione për nënkontraktorin 			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me të për t'u nënkontraktuar

Nuk ka

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Nuk ka

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: https://qkb.gov.al / https://e-albania.al/ dhe dokumenti është Ekstrakti i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” dhe Ekstrakti Historik Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të paraqitura në tabelën e mëposhtme, ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 76*</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it https://e-albania.al/ dhe dokumenti është Dëshmi penaliteti nga Ministria e Drejtësisë</p>

<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emër</th> <th>Mbiemër</th> <th>Vendlindja</th> <th>Datëlindja</th> <th>ID</th> <th>Detyra</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>Tropojë</td> <td>31/05/1981</td> <td></td> <td>Administrator</td> </tr> </tbody> </table> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: https://e-albania.al/ dhe dokumenti është Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore (Dëshmia e Penalitetit) dhe organi lëshues është Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.</p> <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë është Dëshmi Penaliteti nga Ministria e Drejtësisë.</p>	Emër	Mbiemër	Vendlindja	Datëlindja	ID	Detyra			Tropojë	31/05/1981		Administrator
Emër	Mbiemër	Vendlindja	Datëlindja	ID	Detyra							
		Tropojë	31/05/1981		Administrator							

<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: https://www.tatime.gov.al/https://e-albania.al/dhe dokumenti është Vërtetimi për statusin Aktiv, Pasive etj dhe organi lëshues është Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM.</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: www.e-albania.al dhe dokumenti është Vërtetimi debi dhe organi lëshues është OSHEE Group sh.a.(FSHU).</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontribute legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin.</p> <p>Operatori ekonomik i ka paguar taksat lokale</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: www.e-albania.al dhe dokumenti është Vërtetimi për pagim detyrimesh dhe organi lëshues është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme</p>

<p>e Tatimeve.</p> <p>OE do të dorzojë vërtetimin e pagimit të taksave lokale për vitin 2023 nëq shpallet fitues</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p>
<p>Dokumentacioni për këtë deklaratë gjendet në adresën e ueb-it: http://app.gov.al dhe dokumenti është Operatorët ekonomik të përjashtuar nga pjesmarrja në procedurat e prokurimit publik dhe organi lëshues është Agjencia e Prokurimit Publik .</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

<p>Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik "ANBIM" SH.P.K., në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> <ol style="list-style-type: none"> Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate; Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt; Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit; Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit; Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkimoperatorësh ekonomik, që: <ol style="list-style-type: none"> Paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/Ofertës të bërë... by Është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): <ol style="list-style-type: none"> Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar
--

dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

- OE ANBIM shpk e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

OE ANBIM shpk nuk është konsultuar, nuk ka komunikuar, nuk ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi prandaj ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, nuk janë dhe nuk ka të përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Nëveçanti, pa kufizuarparagrafët 6. a) dhe 6. b), tëpërmendurmëlart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjëkonkurrent në lidhje me:

- a) çmimet;
b) metodat, faktorëtoseformulat e përdorurapërlllogaritjen e çmimit;
c) qëlliminapovendiminpërtëparaqiturapojnjëofertë; ose,
d) paraqitjen e njëoferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveçkësaj, nuk ka pasurkonsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve tëcilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para dates dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen nëmënyrë specifike sipasparagrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik "ANBIM" S.H.P.K., ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve sic parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë. nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministër, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik "ANBIM" SH.P.K., deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> Operatori ekonomik "ANBIM" SH.P.K. garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Operatori ekonomik "ANBIM" SH.P.K. lidh me punëmarrësit kontratat masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Operatori ekonomik "ANBIM" SH.P.K. nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**A: DEKLARATË**

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	OE ANBIM shpk deklaron se plotëson të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provon përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti	Operatorit ekonomik, Anbim shpk deklaron me përgjegjësi të plotë se i ka punonjësit e nevojshëm mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fiton, ose nëse i kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor <u>Punoniës</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>] Nëse, po, numri i punonjësve: 12 (dhjetë) <hr/> Profili i punonjësve Punëtor, magaziner, punëtor <u>Makineri e mjete</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]

Nr.	Targa	Pronësi / Qira
1.		Qira kap 1900
2.		Qira kap 1900
3.		Qira kap 3500

Emri, Mbiemri
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës 05.08.2024

III.1.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja

detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e

prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepr penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, 42 sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j

) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor

janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin konkret Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues "Anbim" SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në këtë formular vetëdeklarimi, shtojca 8 e DST, verehet se operatori ekonomik "Anbim" SHPK ka plotësuar të gjitha vëndet të cilat janë të detyruara për tu plotësuar nga operatorët ekonomikë si dhe është firmosur dhe vulosur në cdo faqe. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka ofertuar sipas shtojcës 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për paraqitjen e saktë të formularit të Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik ankimues përmbush kriteret për kualifikim me paraqitjen e dokumentit Shtojca 8...., të plotësuar në të gjithë elementët përmbajtësor të tij si dhe firmosur e vulosur, në cdo faqe për të treguar vërtetësinë e të gjitha deklaratave por edhe përgjegjshmërinë për çka ka deklaruar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues "Anbim" SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi ka paraqitur shtojcën 8 sipas formatit të rregullt, duke përmbushur "Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit", pjesë e dokumenteve të tenderit.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Anbim" SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Anbim" SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: *"Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e*

prokurimit) nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit. Konkretisht nga verifikimi i Faturave të paraqitura ne SPE rezulton se: - Fatura nr. 402/2023 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 405/2023 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë. - Fatura nr.374/2023 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 40/2024 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë. - Fatura nr 13/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturat nr.30/2022 dhe faturën nr.15/2022 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë. - Fatura me nr 120/2022 rezulton e korigjuar (me vlerë negative) me faturat nr.123/2022 dhe 127/2022 dhe nuk llogariten vlerat e korigjuara. - Fatura nr.65/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 70/2022 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë” nuk qëndron Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
 - a. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
 - b. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.2.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike

1. **Solucion larës dyshemeje (pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm^3 - 1.1 gr/cm^3 . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

2. **Sapun tualeti duarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %.Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.
3. **Sapun i lëngshëm :** ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi.Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11 %.Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
4. **Solucion larës xhamash,** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi.Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0 % deri në 4.0 %.
5. **Solucion larës ËC dezinfektues:** Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5 %.
6. **Solucion lares linoleumi :** Solucion për pastrimin e sipërfaqjeve të veshur me linoleum,detergjent acid me vlera të pH 3-5 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
7. **Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi.** Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi. Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, zmerçet me te forta, ndryshkun,të pastrojë në thellësi kriperat e ujit . Të parandalojë krijimin e kriperave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene.Ben sipërfaqjen e ndritshme,parandalon formimin e zmerçit dhe të papastertive. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
8. **Solucion larës për mobilje (pastrues dyersh):** Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100 % në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera

e PH të jetë nga 6 deri në 7.5 Përmbajtja e lendeve tensioaktive të jetë jo me shume se 7%.

9. **Solucion Pastrimi Mermeri:** Të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri ne 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³.Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike.
10. **Acid për pastrim,** të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100 %.Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
11. **Solucion për zhbllokim lavamani:** Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
12. **Solucion per pastrim Mobiljesh:**Perberja e lendeve tension aktive me e vogel se 5%,alkoli izopropilik me e vogel se 20%,uje i distiluar.Emulsioni te kete vaj esence dhe sistem novator dozimi.Ambalazhi ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
13. **Solucion për pastrim të parketit.** Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo me pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale (jo me shume se 5.5 %.

III.2.3. Në shtojcën 6 “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

LOTI 1 "BLERJE DETERGJENT PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NENE TEREZA"				
Nr.	Emertimi artikujve	Njesia	Sasia e pritshme për 24 muaj	Periudha e dorezimit
1	Solucion Larës Pllakash dyshemeje (ambalazh >1litra)	litra	80000	30 (tridhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të minikontratës
2	Sapun tualeti i ngurte (ambalazh 150 gr)	cope	10000	

3	Sapun i lengshem (ambalazh 500 ml)	cope	60000	përkatëse brenda afatit të marrëveshjes kuader prej 24 (njëzet e katër) muajsh	
4	Solucion Xhamash (ambalazh 1 L)	cope	10000		
5	Solucion Larës ËC (ambalazh 750 ml)	cope	24000		
6	Solucion lares linoleumi (ambalazh 1 L)	cope	20000		
7	Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi. (ambalazh 1 L)	cope	1000		
8	Solucion Pastrues dyerve (per dyert e bardha (ambalazh 1 L)	cope	1000		
9	Solucion pastrimi mermeri (ambalazh 1 L)	cope	4000		
10	Acid për pastrim (ambalazh 1L)	cope	4000		
11	Solucion per cbllokim lavamani (ambalazh 1 L)	cope	1600		
12	Solucion pastrimi mobilje (ambalazh 1 L)	cope	2200		
13	Solucion per parket (ambalazh 1 L)	cope	400		
VLERA TOTALE			19,092,667 leke pa TVSH		

III.2.4. . Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

Faturat nr. 65, datë 13.04.2022; nr. 120, datë 02.09.2022; nr. 50, datë 07.03.2022; nr. 200, datë 22.12.2022; nr. 60, datë 10.04.2022; nr. 199, datë 20.12.2022; nr. 32, datë 21.02.2022; nr. 71, datë 14.04.2022; nr. 54, datë 16.03.2022; nr. 407, datë 13.12.2023; nr. 144, datë 03.11.2022; nr. 374, datë 14.11.2023; nr. 86, datë 30.05.2022; nr. 372, datë 10.11.2023; nr. 24, datë 10.02.2022; nr. 103, datë 08.08.2022; nr. 155, datë 09.11.2022; nr. 402, datë 12.12.2023; nr. 51, datë 08.03.2022; nr. 52, datë 09.03.2022; nr. 152, datë 07.11.2022; nr. 154, datë 09.11.2022; nr. 404, datë 13.12.2023; nr. 367, datë 02.11.2023; nr. 186, datë 07.12.2022; nr. 205, datë 27.12.2022; nr. 375, datë 17.11.2023; nr. 370, datë 08.11.2023; nr. 410, datë 19.12.2023;

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.2.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin

dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *“dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, konstatohet se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Fatura Tatimore ku vërteton se ka kryer furnizime të mëparshme me produkte të ngjashme me objektin e prokurimit me disa institucione shtetërore dhe private (shiko piken III.2.4. të këtij vendimi). Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar dëshmon, se ka kryer furnizime të ngjashme si sfungjer enësh, tel enësh, fshesa plastike, shkopinjë për fshesa plastike, kova pastrimi, shtupa mikrofibër, furca për mirimanga, qese mbeturinash, doreza për duart, letër për duart rulon, letër higjienike, rulon telefon, letër guzhine, peshqir, kosha për zyrë, shtroje për zyrë. Zërat e sipërcituar nuk kanë asnjë ngjashmëri si përsa i përketë përbërjes së tyre ashtu dhe përdrueshmërisë me zërat objekt prokurimi të përcaktuar në shtojcën 6 të DST. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi janë mallra solucione larës për duart dhe ambjente si dysheme dhe xhama, tavolina e dyer të cilat kanë një veprimtari dhe përbërje specifike të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimuesi në pjesën më të madhe me anë të faturave tatimore, pasi dhe vetë metodologjia e përbërjes dhe përdorimit të tyre është e ndryshme. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se faturat e paraqitura nga

operatori ekonomik ankimes janë punë fatura furnizimi me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre faturave nuk ka mjaftueshëm zëra të ngjashme në natyrë dhe metodologji me zërat furnizimit objekt-prokurimi. Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur fatura tatimore në të cilat vërteton se ndër të tjera ka kryer furnizime gjatë tre viteve të fundit me artikujt objekt prokurimi të lotit I (blerje detergjent për QSUT), por KPP pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, si më sipër cituar, vëren se, nga përlllogaritja zërat e ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, janë në vlerën 5.044.524 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit, pra në vlerën 7.446.140 lekë pa Tvsh.

Sa më sipër, për sa kohë operatori ekonomik “Anbim” SHPK, nuk përmbush kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit*, rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i papërmbushur.

III.2.10. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.11. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomikë “Anbim” SHPK nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.2.12. Në rast se operatori ekonomik “Anbim” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet

e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Anbim” nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK se arsyeja e skualifikimit “*Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme), pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm për artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit)nuk plotëson limitin prej 39% të Fondit limit*”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se::

III.3.1. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*” pika 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
 - c. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
 - d. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.3.2. Në shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike

- 14. Solucion larës dyshemeje (pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm^3 - 1.1 gr/cm^3 . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 15. Sapun tualeti duarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm^3 . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.
- 16. Sapun i lëngshëm :** ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më e vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm^3 . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 17. Solucion larës xhamash,** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm^3 deri në 1.2 gr/cm^3 . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0 % deri në 4.0 %.
- 18. Solucion larës ĘC dezinfektues:** Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ĘC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm^3 deri në 1.1 gr/cm^3 . Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5 %.
- 19. Solucion lares linoleumi :** Solucion për pastrimin e sipërfaqjeve të veshur me linoleum, detergjent acid me vlera të pH 3-5 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 20. Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitariet me mekanizëm sprucimi.** Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitariet me mekanizëm sprucimi. Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, zmerçet me te forta, ndryshkun, të pastrojë në thellësi kriprat e ujit . Të parandalojë krijimin e kriprave.

Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Ben sipërfaqjen e ndritshme, parandalon formimin e zmerçit dhe te papastertive. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

21. Solucion larës për mobilje (pastrues dyersh): *Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100 % në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5 Përmbajtja e lendeve tensioaktive të jetë jo me shume se 7%.*

22. Solucion Pastrimi Mermeri: *Të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri ne 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike.*

23. Acid për pastrim, *të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100 %. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.*

24. Solucion për zhbllokim lavamani: *Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.*

25. Solucion per pastrim Mobiljesh: *Perberja e lendeve tension aktive me e vogel se 5%,alkoli izopropilik me e vogel se 20%,uje i distiluar.Emulsioni te kete vaj esence dhe sistem novator dozimi.Ambalazhi ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.*

26. Solucion për pastrim të parketit. *Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo me pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale (jo me shume se 5.5 %.*

III.3.3. Në shtojcën 6 “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

**LOTI 1 "BLERJE DETERGJENT PËR QENDRËN SPITALORE
UNIVERSITARE "NENE TEREZA"**

Nr.	Emertimi artikujve	Njesia	Sasia e pritshme për 24 muaj	Periudha e dorezimit
1	Solucion Larës Pllakash dyshemeje (ambalazh >1litra)	litra	80000	30 (tridhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të minikontratës përkatëse brenda afatit të marrëveshjes kuader prej 24 (njëzet e katër) muajsh
2	Sapun tualeti i ngurte (ambalazh 150 gr)	cope	10000	
3	Sapun i lengshem (ambalazh 500 ml)	cope	60000	
4	Solucion Xhamash (ambalazh 1 L)	cope	10000	
5	Solucion Larës ËC (ambalazh 750 ml)	cope	24000	
6	Solucion lares linoleumi (ambalazh 1 L)	cope	20000	
7	Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi. (ambalazh 1 L)	cope	1000	
8	Solucion Pastrues dyerve (per dyert e bardha (ambalazh 1 L)	cope	1000	
9	Solucion pastrimi mermeri (ambalazh 1 L)	cope	4000	
10	Acid për pastrim (ambalazh 1L)	cope	4000	
11	Solucion per cbllokim lavamani (ambalazh 1 L)	cope	1600	
12	Solucion pastrimi mobilje (ambalazh 1 L)	cope	2200	
13	Solucion per parket (ambalazh 1 L)	cope	400	
VLERA TOTALE			19,092,667	leke pa TVSH

III.3.4. . Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

Faturat nr. 106634, datë 12.07.2022; nr. 107267, datë 02.08.2022; nr. 107304, datë 03.08.2022; 100676, datë 19.01.2022; nr. 100630, datë 18.01.2022; nr. 100891, datë 24.01.2022; nr. 100890, datë 24.01.2022; nr. 100636, datë 18.01.2022; nr.100959, datë 25.01.2022; nr.

101451, datë 08.02.2022; nr. 104062, datë 21.04.2022; nr. 104311, datë 29.04.2022; nr. 104479, datë 05.05.2022; nr. 104478, datë 05.05.2022; nr. 104881, datë 17.05.2022; nr. 104724, datë 12.05.2022; nr. 104726, datë 12.05.2022; nr. 105329, datë 31.05.2022; nr. 105695, datë 09.12.2021; nr. 10146, datë 02.10.2023; nr. 101294, datë 13.08.2021; nr. 101293, datë 13.08.2021; nr. 101293, datë 13.08.2021; nr. 14013, datë 28.12.2023;

Faturat nr. 100567, datë 17.01.2022; nr.100554, datë 17.01.2022; nr. 703, datë 13.01.2024; nr. 5586, datë 29.04.2024; nr. 5419, datë 25.04.2024; nr. 5312, datë 23.04.2024; nr. 6419, datë 20.05.2024; nr. 3148, datë 07.03.2024; nr. 7076, datë 04.06.2024; nr. 5003, datë 16.04.2024; nr. 6537, datë 23.05.2024; nr. 5919, datë 09.05.2024; nr. 8036, datë 21.06.2024; nr. 5711, datë 03.05.2024; nr. 9065, datë 11.09.2023; nr. 10351, datë 05.10.2023; nr. 10265, datë 04.10.2023; nr. 12294, datë 18.11.2023; nr. 12559, datë 24.11.2023; nr. 12700, datë 30.11.2023; nr. 12367, datë 20.11.2023; nr. 13892, datë 26.12.2023; nr. 13387, datë 14.12.2023; nr. 55, datë 05.01.2023; nr. 2933, datë 28.03.2023; nr. 3747, datë 24.04.2023; nr. 5046, datë 26.05.2023; nr. 4098, datë 03.05.2023; nr. 5694, datë 13.06.2023; nr. 7478, datë 31.07.2023; nr. 7065, datë 20.07.2023; nr. 8353, datë 23.08.2023; nr. 8663, datë 31.08.2023; nr. 9821, datë 25.09.2023; nr. 9621, datë 20.09.2023; nr. 6050, datë 22.06.2023; nr. 5882, datë 17.06.2022; nr. 103751, datë 12.04.2022; nr.106231, datë 28.06.2022; nr. 137, datë 06.01.2023; nr. 109102, datë 03.10.2022; nr. 103185, datë 01.10.2021; nr. 104342, datë 01.11.2021; nr. 105403, datë 01.12.2021; nr. 103121, datë 23.03.2022; nr. 101951, datë 17.02.2022; nr. 104637, datë 10.05.2022; nr. 104638, datë 10.05.2022; nr. 104239, datë 27.04.2022; nr. 100125, datë 06.01.2022; nr. 101951, datë 17.02.2022.

III.3.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.3.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë*

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.3.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstatohet se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Fatura Tatimore ku vërteton se ka kryer furnizime të mëparshme me produkte të ngjashme me objektin e prokurimi me disa institucione shtetërore dhe private (shiko piken III.3.4. të këtij vendimi). Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimes, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar dëshmon, se ka kryer furnizime të ngjashme me zërat si vijon (Detergjent xhami, Detergjent rrobash, Sapun i lengshëm, Benza Flor Spry, Alkol 96 %, Bactiflor, Sapun rrobash, Sapun tualeti, Acid muratik, Detergjent lavatrice, Detergjent enesh, Vim pastrimi, Flor ddac, Flor ace, Flor larës, Florguard, Flor xidine, Detergjent larje dysHEMEJE, Flor dex, Alkol 95 %, Alkol 90 %, Alkol 70 %.). Pra përveç zërave të produkteve të përcaktuara në shtojcën 6 të DST ka dorëzuar edhe fatura për alkol 95 %, Alkol 96 %, Alkol 90 %, Alkol 70 %, produkte këtë të cilat nuk kanë asnjë ngjashmëri si përsa i përketë përbërjes së tyre ashtu dhe përdrueshmërisë me zërat objekt prokurimi të përcaktuar në shtojcën 6 të DST. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi janë mallra solucione larës për duart dhe ambjente si dysHEME dhe xhama, tavolina e dyer të cilat kanë një veprimtari dhe përbërje specifike të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimesi në pjesën më të madhe me anë të faturave tatimore për alkol, pasi dhe vetë metodologjia e përbërjes dhe përdorimit të tyre është e ndryshme, pasi alkoli nuk mund të përdoret si solucion pastrimi. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes janë fatura furnizimi me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre faturave nuk ka mjaftueshëm zëra të ngjashme në natyrë dhe metodologji me zërat furnizimit objekt-prokurimi. Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur fatura tatimore në të cilat vërteton se ndër të tjera ka kryer furnizime gjatë tre viteve të fundit me artikujt objekt prokurimi të lotit I (blerje detergjent për QSUT), por KPP pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, si më sipër cituar, vëren se, nga përlllogaritja zërat e ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, janë në vlerën 2.455.525 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit, pra në vlerën 7.446.140 lekë pa Tvsh.

Sa më sipër, për sa kohë operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, nuk përmbush kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit*, rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i papërmbushur.

III.3.10. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.11. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomikë “Florfarma” SHPK nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.3.12. Në rast se operatori ekonomik “Florfarma” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “I&V Company” SHPK se arsyeja e skualifikimit “Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme), pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm për artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit)nuk plotëson limitin prej 39% të Fondit limit”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
 - e. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
 - f. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.4.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike

27. **Solucion larës dyshemeje (pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ - 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
28. **Sapun tualeti duarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %.Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.

29. **Sapun i lëngshëm** : ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11 %. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
30. **Solucion larës xhamash**, me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0 % deri në 4.0 %.
31. **Solucion larës ËC dezinfektues**: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5 %.
32. **Solucion lares linoleumi** : Solucion për pastrimin e sipërfaqeve të veshur me linoleum, detergjent acid me vlera të pH 3-5 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
33. **Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi**. Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi. Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, zmerçet me te forta, ndryshkun, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit . Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Ben sipërfaqjen e ndritshme, parandalon formimin e zmerçit dhe të papastertive. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
34. **Solucion larës për mobilje (pastrues dyersh)**: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100 % në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5 Përmbajtja e lendeve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%.
35. **Solucion Pastrimi Mermeri**: Të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9

gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike.

36. **Acid për pastrim**, të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
37. **Solucion për zhbllokim lavamani**: Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
38. **Solucion për pastrim Mobiljesh**: Perberja e lendeve tension aktive me e vogel se 5%, alkoli izopropilik me e vogel se 20%, uje i distiluar. Emulsioni te kete vaj esence dhe sistem novator dozimi. Ambalazhi ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
39. **Solucion për pastrim të parketit**. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo me pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale (jo me shume se 5.5 %.

III.4.3. Në shtojcën 6 “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

LOTI 1 "BLERJE DETERGJENT PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NENE TEREZA"				
Nr.	Emertimi artikujve	Njesia	Sasia e pritshme për 24 muaj	Periudha e dorezimit
1	Solucion Larës Pllakash dyshemeje (ambalazh >1litra)	litra	80000	30 (tridhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të minikontratës përkatëse brenda afatit të marrëveshjes kuader prej 24 (njëzet e katër) muajsh
2	Sapun tualeti i ngurte (ambalazh 150 gr)	cope	10000	
3	Sapun i lengshem (ambalazh 500 ml)	cope	60000	
4	Solucion Xhamash (ambalazh 1 L)	cope	10000	
5	Solucion Larës ËC (ambalazh 750 ml)	cope	24000	

6	Solucion lares linoleumi (ambalazh 1 L)	cope	20000
7	Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi. (ambalazh 1 L)	cope	1000
8	Solucion Pastrues dyerve (per dyert e bardha (ambalazh 1 L)	cope	1000
9	Solucion pastrimi mermeri (ambalazh 1 L)	cope	4000
10	Acid për pastrim (ambalazh 1L)	cope	4000
11	Solucion per cbllokim lavamani (ambalazh 1 L)	cope	1600
12	Solucion pastrimi mobilje (ambalazh 1 L)	cope	2200
13	Solucion per parket (ambalazh 1 L)	cope	400
VLERA TOTALE			19,092,667 leke pa TVSH

III.4.4. . Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “I&V Company” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Kontratë nr. prot. 1894/3 prot, datë 29.08.2022, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Cerdheve dhe Kopshteve dhe operatorit ekonomik “I&V Company” SHPK me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi”, me vlerë 13.747.000 lekë pa TVSH.
- Vërtetim realizim kontrate nr. 881/1 prot., datë 17.07.2023, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Cerdheve dhe Kopshteve.

III.4.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.4.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të

fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.4.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “I&V Company” SHPK, konstatohet se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Kontratë furnizimi ku vërteton se ka kryer furnizime të mëparshme me produkte të ngjashme me objektin e prokurimit me disa institucione shtetërore (shiko piken III.4.4. të këtij vendimi). Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimes, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar dëshmon, se ka kryer furnizime të ngjashme si sfungjer enësh, tel enësh, peceta pastrimi, doreza pastrimi, kova, fshesa me bisht, shtupa me bisht, letër higjienike dhe peceta duarsh. Zërat e sipërcituar nuk kanë asnjë ngjashmëri si përsa i përketë përbërjes së tyre ashtu dhe përdorueshmërisë me zërat objekt prokurimi të përcaktuar në shtojcën 6 të DST. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi janë mallra solucione larës për duart dhe ambjente si dysheme dhe xhama, tavolina e dyer të cilat kanë një veprimtari dhe përbërje specifike të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimesi në pjesën më të madhe me anë të kontratës së furnizimit, pasi dhe vetë metodologjia e përbërjes dhe përdorimit të tyre është e ndryshme. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes janë punë fatura furnizimi me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre faturave nuk ka mjaftueshëm zëra të ngjashme në natyrë dhe metodologji me zërat furnizimit objekt-prokurimi. Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “I&V Company” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur kontratë furnizimi në të cilat vërteton se ndër të tjera ka kryer furnizime gjatë tre viteve të fundit me artikujt objekt prokurimi të lotit I (blerje detergjent për QSUT), por KPP pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, si më sipër cituar, vëren se, nga përlllogaritja zërat e ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “I&V Company” SHPK, janë në vlerën 4.960.000 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit, pra në vlerën 7.446.140 lekë pa Tvsh.

Sa më sipër, për sa kohë operatori ekonomik “ I&V Company” SHPK, nuk përmbush kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *në një vlerë jo më pak se 39 % të vlerës së fondit të limit*, rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i papërmbushur.

III.4.10. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.11. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomikë “I&V Company” SHPK nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.4.12. Në rast se operatori ekonomik “I&V Company” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre

në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “I&V Company” nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, për lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit e padrejtë të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e ankimuesve “Florfarma” SHPK, “Anbimi” SHPK dhe “I&V Company” SHPK në lidhje me skualifikimin e tyre nga ana e autoritetit kontraktor qëndron, pra edhe pas shqyrtimit të ankesave të këtyre operatorëve ekonomikë nga ana e Komisionit Prokurimit Publik gjëndja faktike dhe juridike e tyre do vijojë të mbetet e skualifikuar, ndaj trajtimi i pretendimeve të ankimuesit “Euro Mega 2010” SHPK në lidhje me shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “Florfarma” SHPK, “Anbimi” SHPK dhe “I&V Company” SHPK nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, sa kohë që gjëndja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë “Florfarma” SHPK, “Anbimi” SHPK dhe “I&V Company” SHPK edhe pas trajtimit të ankesave nga ana e Komisionit Prokurimit Publik do të vijojnë të mbeten të skualifikuar, ndaj për rrjedhojë pretendimet e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjëndjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i

këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*I&V Company*” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
4. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operator ekonomik “*Anbim*” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimes “*Florfarma*” SHPK, “*I&V Company*” SHPK dhe “*Euro Mega 2010*” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini
	Kryetar		
	Jonaid Myzyri		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova, në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik shpreh mendimin kundër përsa i përket arsyetimit të vendimit mbi themelin e çështjes dhe rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK në lidhje me arsyen e skualifikimit përsa i përketë punëve të ngjashme të paraqitura për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: *Loti 1 “Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:**

g. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

- h. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike

1. **Solucion larës dyshemeje (pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm^3 - 1.1 gr/cm^3 . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
2. **Sapun tualeti duarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm^3 . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.
3. **Sapun i lëngshëm :** ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më e vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm^3 . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
4. **Solucion larës xhamash,** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm^3 deri në 1.2 gr/cm^3 . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0 % deri në 4.0 %.
5. **Solucion larës ËC dezinfektues:** Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm^3 deri në 1.1 gr/cm^3 . Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5 %.
6. **Solucion lare linoleumi :** Solucion për pastrimin e sipërfaqjeve të veshur me linoleum, detergjent acid me vlera të pH 3-5 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

7. **Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi.** Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi. Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, zmerçet me te forta, ndryshkun, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit . Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Ben sipërfaqjen e ndritshme, parandalon formimin e zmerçit dhe te papastertive. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
8. **Solucion larës për mobilje (pastrues dyersh):** Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100 % në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5 Përmbajtja e lendeve tensioaktive të jetë jo me shume se 7%.
9. **Solucion Pastrimi Mermeri:** Të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri ne 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike.
10. **Acid për pastrim,** të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100 %. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
11. **Solucion për zhbllokim lavamani:** Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
12. **Solucion per pastrim Mobiljesh:** Perberja e lendeve tension aktive me e vogel se 5%, alkoli izopropilik me e vogel se 20%, uje i distiluar. Emulsioni te kete vaj esence dhe sistem novator dozimi. Ambalazhi ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
13. **Solucion për pastrim të parketit.** Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo me pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale (jo me shume se 5.5 %.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

Faturat nr. 106634, datë 12.07.2022; nr. 107267, datë 02.08.2022; nr. 107304, datë 03.08.2022; 100676, datë 19.01.2022; nr. 100630, datë 18.01.2022; nr. 100891, datë 24.01.2022; nr. 100890, datë 24.01.2022; nr. 100636, datë 18.01.2022; nr.100959, datë 25.01.2022; nr. 101451, datë 08.02.2022; nr. 104062, datë 21.04.2022; nr. 104311, datë 29.04.2022; nr. 104479, datë 05.05.2022; nr. 104478, datë 05.05.2022; nr. 104881, datë 17.05.2022; nr. 104724, datë 12.05.2022; nr. 104726, datë 12.05.2022; nr. 105329, datë 31.05.2022; nr. 105695, datë 09.12.2021; nr. 10146, datë 02.10.2023; nr. 101294, datë 13.08.2021; nr. 101293, datë 13.08.2021; nr. 101293, datë 13.08.2021; nr. 14013, datë 28.12.2023;

Faturat nr. 100567, datë 17.01.2022; nr.100554, datë 17.01.2022; nr. 703, datë 13.01.2024; nr. 5586, datë 29.04.2024; nr. 5419, datë 25.04.2024; nr. 5312, datë 23.04.2024; nr. 6419, datë 20.05.2024; nr. 3148, datë 07.03.2024; nr. 7076, datë 04.06.2024; nr. 5003, datë 16.04.2024; nr. 6537, datë 23.05.2024; nr. 5919, datë 09.05.2024; nr. 8036, datë 21.06.2024; nr. 5711, datë 03.05.2024; nr. 9065, datë 11.09.2023; nr. 10351, datë 05.10.2023; nr. 10265, datë 04.10.2023; nr. 12294, datë 18.11.2023; nr. 12559, datë 24.11.2023; nr. 12700, datë 30.11.2023; nr. 12367, datë 20.11.2023; nr. 13892, datë 26.12.2023; nr. 13387, datë 14.12.2023; nr. 55, datë 05.01.2023; nr. 2933, datë 28.03.2023; nr. 3747, datë 24.04.2023; nr. 5046, datë 26.05.2023; nr. 4098, datë 03.05.2023; nr. 5694, datë 13.06.2023; nr. 7478, datë 31.07.2023; nr. 7065, datë 20.07.2023; nr. 8353, datë 23.08.2023; nr. 8663, datë 31.08.2023; nr. 9821, datë 25.09.2023; nr. 9621, datë 20.09.2023; nr. 6050, datë 22.06.2023; nr. 5882, datë 17.06.2022; nr. 103751, datë 12.04.2022; nr.106231, datë 28.06.2022; nr. 137, datë 06.01.2023; nr. 109102, datë 03.10.2022; nr. 103185, datë 01.10.2021; nr. 104342, datë 01.11.2021; nr. 105403, datë 01.12.2021; nr. 103121, datë 23.03.2022; nr. 101951, datë 17.02.2022; nr. 104637, datë 10.05.2022; nr. 104638, datë 10.05.2022; nr. 104239, datë 27.04.2022; nr. 100125, datë 06.01.2022; nr. 101951, datë 17.02.2022.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e

tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatoj se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “*dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*”.

III.1.8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, vërej, se ky i fundit ka paraqitur Fatura Tatimore Shitje për furnizimin e disa subjekteve private dhe publike me produkte si (Detergjent xhami, Detergjent rrobash, Sapun i lengshëm, Benza Flor Spry, Alkol 96 %, Bactiflor, Sapun rrobash, Sapun tualeti, Acid muratik, Detergjent lavatriçe, Detergjent enesh, Vim pastrimi, Flor ddac, Flor ace, Flor larës, Florguard, Flor xidine, Detergjent larje dysHEMEJE, Flor dex, Alkol 95 %, Alkol 90 %, Alkol 70 %,).

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentave të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK në lidhje me eksperiencën e ngjashme, KPP, konstaton se, me dokumentacionin e paraqitur, ky i fundit vërteton se ka kryer furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit, duke plotësuar kështu kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit për sa i përket eksperiencës së ngjashme. Referuar faturave tatimore të dorëzuara nga ky operator ekonomik ankimues konstatohet se vlerën me të konsiderueshme e përmbajnë faturat tatimore me objekt shitje alkoli si, Alkol 90 %, Alkol 95 %, Alkol 96 %, Alkol 70 %. Në shtojcën 6 dhe 7 të dokumentave standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar objekti: “BLERJE DETERGJENT, DEZINFEKTANT DHE AROMATIZUES”. Referuar objektit dhe faturave tatimore të paraqitura nga ankimues rezulton se alkoolët janë një nga grupet më të përdorura të dezinfektuesve, dhe efektiviteti i tyre si dezinfektantë bazohet në vetitë e tyre kimike specifike, që lejojnë ndërhyrjen dhe shkatërrimin e strukturave qelizore të mikroorganizmave. Një tjetër karakteristike e rëndësishme e alkoolit si dezinfektues është aktiviteti i tij i shpejtë. Alkoolët kanë një efekt të menjëhershëm kur aplikohen në sipërfaqe të ndryshme, duke filluar denaturimin e proteinave dhe shkatërrimin e membranave në pak sekonda. Kjo është arsyeja pse alkoolët janë shumë të përdorura për dezinfektimin e ambienteve spitalore, dezinfektimin e lëkurës përpara ndërhyrjeve mjekësore ose injeksioneve, pasi ato veprojnë shpejt dhe janë të padëmshme për

qelizat njerëzore kur përdoren në përqendrime të përshtatshme. Gjithashtu shume produkte detergjent përmbajnë Alkool si pjesë e formulimit të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se efektiviteti i alkooleve si dezinfektues varet shumë nga përqendrimi i tyre. Për shembull, Alkoli është me efektiv si dezinfektues kur është në një përqendrim prej 90%, ndërsa përqendrime më të vogla se 90% janë më pak efektive. Nga një perspektive teknike, alkolet janë efektive kundër një game të gjërë mikroorganizmash, përfshirë bakteret gram-pozitive dhe gram-negative, viruset e mbështjella (si virusi i gripit dhe koronavirusi), dhe disa kërpudha. Në përmbledhje për sa më sipër, alkolet janë dezinfektues efektive për shkak të aftësisë së tyre për të denaturuar proteinat dhe shpërndarë membranat lipidike të mikroorganizmave. Shpejtësia e veprimit të tyre dhe thjeshtësia në aplikim i bënë ata të domosdoshëm në mjedisë ku kërkohet dezinfektim i menjëhershëm dhe efikas, si në kujdesin shëndetësor dhe higjenën personale.

Sa më sipër konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstatoj se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjithë elementëve të faturave të paraqitura, vërtetohet se furnizimet e kryera janë të ngjashme me furnizimet që kërkohen nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, si dhe plotësojnë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK, mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin “Florfarma” SHPK me pretendimin se “Operatori ekonomik Florfarma SHPK për pasojë, në këtë procedurë prokurimi nuk i ka plotësuar kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, në lidhje me informacionet të cilat detyrimisht duhet të vendosen dhe deklarohen në shtojcën 8 të DT-së, pra nuk kanë paraqitur shtojcën 8 sipas kërkesave të përcaktura nga AK-ja në shtojcën 7 kriteret e vecanta të kualifikimit, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos dhënë të dhëna që ky formular parashikon”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/1 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 7

LOTI I. “BLERJE DETERGJENT, DEZINFEKTANT DHE AROMATIZUES”

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*

- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

II. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi	-----

tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime *nëse* *vlerësohet* *e* *nevojshme*

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

A. Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

B.

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;

d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

e) çmimet ;

f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

--

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve _____ _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin e përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK

III.2.4. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;*
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.*

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.2.5. Referuar nenit 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*
4. *Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*
6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*
7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë të gjitha kriteret kualifikues në përputhje me kërkesat e AK si në përmbajtjen e tyre edhe në formën e rregullt të përcaktuar.

Nga verifikimet e kryera në DST, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni konstatoi, se dokumenti Shtojca 8 ngarkuar në sistem si pjesë e ofertës së operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, rezulton i plotësuar i firmour dhe vulosur nga personi përgjegjës, në rastin konkret Administratori i Shoqërisë. Gjithashtu ka listuar dhe evidentuar

numrin e mjeteve, markën, targat, si dhe të dhëna në lidhje me punonjësit që disponon në përmbushje të kërkesës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas (shtojca 8), Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, “Nëse po, të listohen me të dhëna konkrete”, mbi disponim të mjeteve të nevojshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar. Referuar fakteve sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe të rregullt në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përkatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK ka ofertuar sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për paraqitjen e saktë të Formularit të Vetëdeklarimit pasi ka paraqitur shtojcën 8 sipas formatit të rregullt, duke përmbushur “Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK nuk qëndron.

Si rrjedhojë e arsytimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, nenit 34 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, gjykoj:

1. Të pranoj ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “*Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të mos pranoj ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK për operatorin ekonomik “*Florfarma*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF 12064-07-03-2024, me objekt: Loti 1 “*Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 190,261 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë

date 02.07.2024 është 100.35 lekë, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Anëtar

Kreshnik Ternova